



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Pml.nr.349/2020

### NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Enver Peci, kryetar Agim Maliqi dhe Mejreme Memaj, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit A.Sh., për shkak të veprave penale: dhunë në familje nga neni 248 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga i dënuari, kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm P.nr.67/2020 të datës 13.07.2020 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.810/2020 të datës 05.11.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur më 23 dhjetor 2020, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e të dënuarit A.Sh. e paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm P.nr.67/2020 të datës 13.07.2020 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.810/2020 të datës 05.11.2020.

### A r s y e t i m

#### **Vendimi i Gjykatës Themelore**

Gjykata Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin P.nr.67/2020 të datës 13.07.2020, e ka shpallur fajtor të dënuarin A.Sh. për shkak të veprave penale: dhunë në

familje nga neni 248 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së dhe e ka gjykuar, me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj dhe dënim me gjobë në lartësi prej 700 (shtatëqind) €, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej datës 26.12.2019 deri me datë 25.01.2020. I dënuari është liruar nga shpenzimet e procedurës penale, kurse i dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

### **Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës**

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PA1.nr. 810/2020 të datës 05.11.2020, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të dënuarit dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

### **Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë**

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, ka paraqitur i dënuari, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve të dispozitave të procedurës penale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.

### **Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit**

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.192/2020 e datës 18.12.2020, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

### **Pretendimet e paraqitura në kërkesë**

Në kërkesë i dënuari thekson se gjykata e shkallës së dytë në aktgjykimin e saj ka lënë në fuqi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë edhe pse është i përfshirë në shkelje të ligjit material dhe procedural. Pretendohet se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i bazuar vetëm në një provë dhe kjo është në kundërshtim me nenin 384 par.1.8 të KPPK-së.

Pretendohet se gjykata e shkallës së parë nuk kishte marrë parasysh rrethanat lehtësuese se palë e dëmtuar në këtë rast ishte djali i të dënuarit me të cilin jetojnë së bashku dhe se i njëjti

nuk ka kërkuar as kompensim të dëmit, dhe po ashtu është theksuar fakti se i dënuari është i sëmurë dhe se dërgimi në vuajtje të dënimit do të kishte ndikim në përkeqësim të shëndetit të tij.

### **Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës**

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

kërkesa nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimi i të dënuarit, është i pabazuar, ngase aktgjykimet kundër të cilave ka parashtruar kërkesë, nuk përmbajnë shkelje për të cilat pretendohet.

Duke vlerësuar pretendimet e të dënuarit fillimisht duhet theksuar faktin se i dënuari në shqyrtimin fillestar kishte bërë pranimin e fajësisë dhe si rezultat i konstatimit të gjykatës se janë përmbushur kriteret e përcaktuara, pranimi i fajësisë është aprovuar. E rëndësishme është të potencohet fakti se pretendimi për shkeljen e dispozitës së nenit 384 par.1.8 të KPPK-së është i pabazuar pasi që në kërkesë pos faktit se është potencuar dispozita ligjore nuk është paraqitur pretendim konkret se ku konsiston shkelja, ashtu që Gjykata Supreme e Kosovës e në kuptim të nenit 436 të KPPK-së, nuk e shqyrtoi këtë pjesë të kërkesës meqë ishte e kufizuar në verifikimin e shkeljeve në kuptim të dispozitës së lartcekur.

Duke vlerësuar pretendimet e theksuara përkitazi me shkeljen e ligjit penal, përkatësisht faktin se gjykatat e dy instancave më të ulëta me rastin e shqiptimit të dënimit nuk kanë marrë parasysh rrethanat lehtësuese, Gjykata Supreme e Kosovës, konstatoj se të dy gjykatat respektive në mënyrë të drejtë kanë zbatuar ligjin penal dhe të dënuarit i kanë shqiptuar dënimin e përcaktuar brenda kornizave të minimumit dhe maksimumit të dënimit të përcaktuar dhe bazuar në dispozitën e nenit 385 par.5 të KPPK-së. Megjithatë kur është fjala për vendimin për dënim, shkelje e ligjit penal bëhet në rastet kur në marrjen e vendimit për dënim, dënim alternativ, vërejtje gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me veprën penale, gjykata ka tejkuluar

kompetencat ligjore. Në rastin konkret drejt është aplikuar ligji penal, ashtu që pretendimi i të dënuarit i paraqitur në kërkesë se aktgjykimi është përfshirë në shkelje të ligjit penal nuk është i bazuar, dhe për më tepër, nuk është në kompetencë të Gjykatës Supreme të Kosovës shqyrtimi i lartësisë së dënimeve të shqiptuara por e rëndësishme është se me rastin e shqiptimit të dënimit nuk janë tejkualuar kompetencat ligjore, dhe arsyet e dhëna për vendimin për dënim, nuk janë të përfshira në shkelje procedurale.

Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 437 par.1 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.349/2020, më 23 dhjetor 2020

B.profesional,  
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,  
Enver Peci